



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.814/6 prot.

Datë 01.04.2026

V E N D I M
Nr. 450/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 01.04.2026 u shqyrtua ankesa me

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “T&J Construction” SHPK në procedurën e prokurimit “*E hapur e thjeshtuar*”, me nr. REF-76107-02-13-2026, me objekt: “*Blerje pemë dekorative*”, me fond limit 2,483,333.33 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 02.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Pasurisë Publike Lushnje.

Autoriteti Kontraktor: Ndërmarrja e Pasurisë Publike, me adresë: Lagjja “Gafurr Muco”, Lushnje

Ankimues: Operatori ekonomik “T&J Construction” SHPK me NUIS M29718101T dhe adresë: Lagjja Teqe, zk.2908, pasuria nr.7/90, Peqin.

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr.

766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 17.02.2026, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me nr. REF-76107-02-13-2026, me objekt: “Blerje pemë dekorative”, me fond limit 2,483,333.33 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 02.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Pasurisë Publike Lushnje.

II.2. Në datën 04.03.2026 autoriteti kontraktor ka përfunduar fazën e vlerësimit të ofertave. Ofertuesit janë njoftuar elektronikisht si vijon:

- | | |
|----------------------------|------------------------------|
| 1. “KEJ Group” SHPK | 936,500 lekë, skualifikuar |
| 2. “Skyline SC” SHPK | 1,065,900 lekë, skualifikuar |
| 3. “T&J Construction” SHPK | 1,910 000lekë, skualifikuar |
| 4. “SARK” SHPK | 2,080,000lekë, skualifikuar |

5. “Erdit Kalemi Kalemi-PF 2,150,000 lekë, kualifikuar

Operatori ekonomik “T&J Construction” SHPK është njoftuar elektronikisht për arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

“Certifikata ISO e paraqitur nga operatori ekonomik nuk perfshin objektin e tenderit.”

II.3. Në datën 12.03.2026 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit të procedurës së prokurimit në SPE.

II.4. Në datën 12.03.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik, me nr. A/2026/6413, protokolluar me nr.814/2026 prot, datë 13.03.2026, i operatorit ekonomik “T&J Construction” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me nr. REF-76107-02-13-2026, me objekt: “Blerje pemë dekorative”, me fond limit 2,483,333.33 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 02.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Pasurisë Publike Lushnje.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “T&J Construction” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Konkretisht pretendohet si vijon:

“Me njoftim vleresimin e dates 04.03.2026 jemi njoftuar ne SPE se jemi skualifikuar ne proceduren me objekt Blerje pemë dekorative me nr. REF-76107-02-13-2026 me date zhvillimi 02.03.2026 te zhvlluar nga ana juaj me arsyetimin se Certifkata ISO e paraqitur nga operatori ekonomik nuk perfshin objektin e tenderit.

Duke mos qene dakort me arsyen e mesiperme te skualifikimit po e kundershtojme si me poshte: Nga ana jone eshte ngarkuar ne SPE Certificate cilesie ISO 9001:2015 Sistemi i Menaxhimitt e Cilesise Certifikatë Nr.: SMC20240523ALTS e cila ne permbajtjen e saj rezulton si me poshte : Kjo Çertifikatë është e zbatueshme në fushën e mëposhtme të aktivitetit të saj: Ndërtim, rikonstruksion dhe mirëmbajtje periodike të infrastrukturës rrugore, ndërtesave civile dhe industriale, ujësjellësave, kanalizimeve, mbrojtje lumore, sisteme hidraulike, diga e bonifikime. Punime elektrike për shpërndarjen dhe transmetimin e energjisë elektrike të TU, TM e TL. Punime të inxhinierisë mjedisore, sinjalistikës rrugore dhe topo-gjeodezike. Prodhim betoni, elemente parafabrikate, materiale inerte e asfalt. Tregtim te materialeve te ndertimit, elektrike, mekanike, hidraulike e industriale. Sektorët EA: 16, 28, 29;.

Pra per sa me siper rezulton se certifikata eshte e zbatueshme dhe per punime te inxhinierise mjedisore ku perfshihen dhe mbrojtja dhe rehabilitimi i Tokës qe perbehet nga punime për parandalimin e erozionit, rehabilitimin e zonave të ndotura (si ish-minierat apo zonat industriale) dhe studime të gjeomjedisit te cilat kane si zgjidhje rehabilituese te situatave te mesiperme mbjelljen e pemeve dekorative.

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 814/1 Prot., datë 13.03.2026.

II.6. Në datën 17.03.2026 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 814/2 prot., shkresa e operatorit ekonomik ankimes me objekt: “Dërgim vendimi”, bashkëngjitur Vendimi nr.441/1/2026, datë 13.03.2026 i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës; Procesverbali nr.1, datë 02.03.2026 i KVO-së mbi hapjen e ofertave të procedurës së mësipërme të prokurimit; Procesverbali nr.2 i KVO-së, datë 04.03.2026 mbi hapjen, zhvillimin dhe vlerësimin e ofertave; Certifikata ISO 9001 e shoqërisë ankimese; Kontratë furnizimi e shoqërisë ankimese, Ekstrakti i Regjistrimit Tregtare të subjektit “T&J Construction” SHPK; Certifikatë Regjistrimi nga QKR për subjektin “T&J Construction” SHPK; Kërkesë për certifikim; Certifikatë origjinale, Formular njoftim fituesi; Klasifikim përfundimtar, deklarimi i anëtarëvetë KVO-SË.

Referuar Vendimit të KSHA-së, rezulton se pretendimet e ankimesit janë refuzuar, duke argumentuar si vijon:

“[...] Vlerësoj se vendimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave qëndron, për arsye se në dokumentat e tenderit është përcaktuar qartë se kërkohet Certifikate ISO që lidhet me objektin e procedurës, konkretisht:

- *EN-ISO 9001 2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë (në lidhje me objektin e tenderit).*
- *Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.*

Certifikata ISO e paraqitur nga ana e operatorit ekonomik ankimes ka të përfshijë në fushën e veprimtarisë të certifikuar “punime të inxhinierisë mjedisore” pa specifikuar punime që lidhen me rehabilitim ose gjelbërim me qëllim krijimin e një lidhjeje funksionale me objektin e kësaj procedure që është “furnizimi me pemë”.

Për më tepër pas rishqyrtimit të dokumentave të paraqitura në SPE vërej se operatori ekonomik ankimes nuk përmbush as kriterin:

3.1. *“Në rast se operatori ekonomik nuk është prodhues, duhet të paraqesë:*

-Kontratë furnizimi me një subjekt të licencuar për prodhim dhe/ose tregtim të materialit mbjellës.

-Kopje të licencës së vlefshme të subjektit furnizues,

për arsye se furnizuesi “Zija Daka” në QKB si fushë të veprimtarisë ka: “Prodhim,tregtim me pakicë lulesh”, duke mos patur kështu lidhje me objektin e tenderit.

Gjithashtu nuk ka një licencë të vlefshme nga ana e furnizuesit pasi dokumenti i paraqitur është “Kërkesë për licencë” dhe jo Licencë e lëshuar nga autoriteti shtetëror përkatës edhe dhe një

“Certifikate Origjine” e firmosur vetëm nga furnizuesi, e paverifikuar nga autoriteti shtetëror duke mos qenë kështu një dokument zyrtar që garanton origjinën.”

II.7. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020, për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga ana e autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “T&J Construction” SHPK, sipas të cilës: *“Certifikata ISO e paraqitur nga operatori ekonomik nuk perfshin objektin e tenderit”* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8/2 *“Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”*, *“Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë”*, pika 2.1, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi është përcaktuar kriteri si më poshtë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- *EN-ISO 9001 2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë(në lidhje me objektin e tenderit).*
- *Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.*

III.1.2. Në shtojcën 7 *“Formulari i Sasisë dhe Grafikut të Lëvrimit”* në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

“Sasia e mallit që kërkohet:

Afatet e lëvrimit:

<i>Artikulli</i>	<i>Përshkrimi</i>	<i>Shuma</i>	<i>Destinacioni</i>	<i>Periudha e dorëzimit</i>
1	<i>Tilia Platyphyllos (Blin) me P.20-25 cm</i>	100	NPP	14 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës.
2	<i>Prunus cerasifera (Kumbulla e kuqe) me P.25cm</i>	30	NPP	14 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës.
3	<i>Platanus acerifolia (Rrap) me P.22-27cm</i>	100	NPP	14 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës.
4	<i>Aeseulus hippocastanum (Gështenja) me P. 20-22cm 2 m nga toka</i>	30	NPP	14 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës.

III.1.3. Në Seksionin 2 “Objekti Kontratës”: “Blerje pemë dekorative”, pika 2.2 “Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP)”, dhe pika 2.3 “Lloji i “Kontratës Publike për furnizim””, të dokumentave standarte të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kodet si më poshtë vijon:

2.2 Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Pemë 03452000-3

2.3 Lloji i “Kontratës Publike për furnizim”

<i>Blerje</i>	<i>Marrje me qira</i>	<i>Blerje me këste</i>	<i>Një kombinim i tyre</i>
X	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

III.1.4. Në Procesverbalin për Argumentimin dhe Miratimin e Spcifikimeve Teknike dhe Krieteve për Kualifikim, të procedurës së prokurimit objekt ankimi të publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, autoriteti kontraktor ka argumentuar si më poshtë vijon:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- *EN-ISO 9001 2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë(në lidhje me objektin e tenderit).*
- *Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.*

Argumentim: *Kërkesat e cilësisë të përcaktuara janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, qe i referohen sistemeve të menaxhimi të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

III.1.5. Në përmbushje të kriterit më sipër operatori ekonomik “T&J Construction” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE dokumentacionin si më poshtë:

Certifikatën ISO 9001:2015, nr. SMC20240523ALTS, datë 23.05.2024, lëshuar nga organizmi certifikues “IAF”, për shoqërinë “ T&J Construction” SHPK, për fushën e aktivitetit “Ndërtim, rikonstruksion dhe mirëmbajtje periodike të infrastrukturës rrugore, ndërtesave civile dhe

industriale, ujësjellësive, kanalizimeve, mbrojtje lumore, sistemime hidraulike, diga e bonifikime. Punime elektrike për shpërndarjen dhe transmetimin e energjisë elektrike të TU, TM e TL. Punime të inxhinierisë mjedisore, sinjalistikës rrugore dhe topo-gjeodezike. Prodhim betoni, elemente parafabrikate, materiale inerte e asfalt. Tregtim të materialeve të ndertimit, elektrike, mekanike, hidraulike e industriale. Sektorët EA: 16, 28, 29;”, me afat vlefshmërie deri në datën 22.05.2027.

III.1.6. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.7. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.8. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së, i ndryshuar, përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.1.9. Në nenin 79, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:

a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;

b) efikasitetit të energjisë;

c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

3. Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara.

4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

III.1.10. Ndërsa në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e furnizimeve”, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë

dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.”

III.1.11. Në nenin 44 “*Kërkesa e cilësisë*” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “

1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, mund të kërkojë një etiketë specifike si një 30 mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, në përputhje me nenin 37 të LPP-së. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

3. Certifikatat dhe etiketat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, si dhe çdo operator ekonomik duhet të ketë akses në to, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

4. Nëse autoriteti/enti kontraktor kërkojnë një certifikatë ose etiketë, ata janë të detyruar të pranojnë çdo certifikatë ose etiketë ekuivalente/të barasvlershme me të ose një dokument që provon të njëjtin informacion.

5. Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor.”.

III.1.12. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 457, datë 30.7.2021 “*Për miratimin e fjalorit të përbashkët të prokurimit*” përcaktohet se:

FJALORI I PËRBASHKËT I PROKURIMIT

LISTA E KODEVE CPV

Shpjegime dhe përshkrime: Fjalori i Përbashkët i Prokurimit është i bazuar në një strukturë bazë, që përfshin kode deri në nëntë shifra, të shoqëruara me një formulim që përshkruan mallrat, punët ose shërbimet, të cilat janë objekt i një procedure prokurimi. Në çdo rast, për zhvillimin e një procedure prokurimi, autoritetet ose entet kontraktore duhet të përzgjedhin detyrimisht në sistemin e prokurimit elektronik një prej kodeve të përcaktuara që i korrespondon objektit konkret të prokurimit. Kodi numerik përbëhet nga 9 shifra, të ndara si më poshtë: - dy shifrat e para identifikojnë ndarjet (XX000000-Y); - tri shifrat e para identifikojnë grupet (XXX00000-Y); - katër shifrat e para identifikojnë klasat (XXXX0000-Y); - pesë shifrat e para identifikojnë kategoritë (XXXXX000-Y). Secila prej tri shifrave të fundit ofron një shkallë më të madhe saktësie brenda secilës kategori. Shifra e nëntë shërben për të verifikuar shifrat e mëparshme

KODI CPV EMËRTIMI I KODIT CPV

03452000-3

Pemë

III.1.13. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kritereve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike janë lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin

ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.14. Në rastin konkret, referuar dokumentave standarte të tenderit, konkretisht seksionit 2 Objekti i Kontratës pika 2.2 “Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP)” autoriteti kontraktor ndër të tjera ka përcaktuar: “03452000-3 Pemë.”. Në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, në seksionin “Të tjera”, në rubrikën “Kodet CPV” përcaktohen grupi i kodeve, emërtimi i kodit CPV dhe Identifikimi i kodit CPV për procedurat e prokurimit elektronik. Sa më sipër, në grupin e kodeve “Pemë” bënë pjesë emërtimi i kodit 03452000-3 dhe identifikimi i kodit Pemë, që përputhet me kodin CPV të procedurës së prokurimit, ndërkohë që objekti i veprimtarisë për të cilën është certifikuar operatori ekonomik ankimues me certifikata ISO 9001:2015, përfshin fushat “Ndërtim, rikonstruksion dhe mirëmbajtje periodike të infrastrukturës rrugore, ndërtesave civile dhe industriale, ujësjellësave, kanalizimeve, mbrojtje lumore, sistemime hidraulike, diga e bonifikime. Punime elektrike për shpërndarjen dhe transmetimin e energjisë elektrike të TU, TM e TL. Punime të inxhinierisë mjedisore, sinjalistikës rrugore dhe topo-gjeodezike. Prodhim betoni, elemente parafabrikate, materiale inerte e asfalt. Tregtim të materialeve të ndërtimit, elektrike, mekanike, hidraulike e industriale. Sektorët EA: 16, 28, 29” ku secili nga këto aktivitete është i identifikueshëm me kodet respektive EA: 16, 28, 29, kode të cilat referuar VKM nr. 320, datë 28.05.2014 “Për miratimin e nomenklaturës së veprimtarive ekonomike të Revizionuara (Rev 2)” kanë në përbërje disa nënkategori apo klasa NACE, nga verifikimi i të cilave rezulton se asnjëra nga kodet e sipercituara të certifikatave nuk përfshin objektin e procedurës së prokurimit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se arsyeja e skualifikimit për operatorin ekonomik ankimues qëndron, pasi certifikata ISO 9001:2015, e paraqitur nga ana e operatorit ekonomik ofertues “T&J Construction” SHPK nuk e plotëson kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.1 “Kapacitetin teknik” të shtojcës 8/2, “Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, pasi në fushënveprimin e kësaj certifikate, referuar kodit të sipërcituar, nuk është i përfshirë objekti i prokurimit, i përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor në pikën 2 të Seksionit 2 “Objekti i Kontratës” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit. Në rastin konkret, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik kryen aktivitetin objekt-prokurimi sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare, vërtetuar kjo nëpërmjet paraqitjes të certifikatave ISO 9001:2015. Në këto kushte KPP gjykon, se operatori ekonomik “T&J Construction” SHPK nuk plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.1 “Kapacitetin teknik” të shtojcës 8/2 “Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” të dokumentave standarte të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër, KPP sqaron, se subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e

përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor, e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme. Operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

Pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

III.2. Së fundi, KPP konstaton se në kthim përgjigjen drejtuar ankimuesit KSHA ka shtuar pretendime/arsye skualifikimi për operatorin ekonomik ankimues të cilat nuk i janë komunikuar në momentin e vlerësimit përfundimtar të ofertave nga KVO. Konkretisht janë shtuar arsye skualifikimi si vijon:

“Për më tepër pas rishqyrtimit të dokumentave të paraqitura në SPE vërej se operatori ekonomik ankimues nuk përmbush as kriterin:

3.1. *“Në rast se operatori ekonomik nuk është prodhues, duhet të paraqesë:*

-Kontratë furnizimi me një subjekt të licencuar për prodhim dhe/ose tregtim të materialit mbjellës.

-Kopje të licencës së vlefshme të subjektit furnizues,

për arsye se furnizuesi “Zija Daka” në QKB si fushë të veprimtarisë ka: “Prodhim,tregtim me pakicë lulesh”, duke mos patur kështu lidhje me objektin e tenderit.

Gjithashtu nuk ka një licencë të vlefshme nga ana e furnizuesit pasi dokumenti i paraqitur është “Kërkesë për licencë” dhe jo Licencë e lëshuar nga autoriteti shtetëror përkatës edhe dhe një “Certifikate Origjine” e firmosur vetëm nga furnizuesi, e paverifikuar nga autoriteti shtetëror duke mos qenë kështu një dokument zyrtar që garanton origjinën.”

III.2.1 Në nenin 80 të Ligjit nr.162 date 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se: *“1. Kontratat jepen mbi bazën e kriterëve të përcaktuara, pasi autoriteti ose enti kontraktor të ketë verifikuar që janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:*

a) oferta përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë dhe në dokumentet e tenderit, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, variantet e paraqitura;

b) operatori ekonomik, që ka dorëzuar ofertën, përmbush kriteret e kualifikimit e të përzgjedhjes dhe nuk ndodhet në ndonjë nga situatat që përbëjnë shkak për skualifikim.

2. Autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin refuzimin e ofertës, pavarësisht vlerës së saj, nëse vlerësohet se oferta e paraqitur nuk është në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit vendas, marrëveshjeve ndërkombëtare ose legjislacionit vendas në fushën e mjedisit, mbrojtjes shoqërore dhe punës.

3. Autoritetet ose entet kontraktore i shqyrtojnë ofertat e paraqitura bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga operatorët ekonomikë dhe legjislacionin përkatës në fuqi

4. Në çdo rast, nëse autoriteti ose enti kontraktor vihet në dijeni të një fakti që është kusht për skualifikimin e operatorit ekonomik të shpallur fitues, deri në momentin e lidhjes së kontratës merr vendim për skualifikimin e tij sipas parashikimeve në këtë ligj

III.2.2. Në nenin 82 pika 2 të Vendimit nr.285 të Këshillit të Ministrave datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet se “*. Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë: i. “Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit; ii. “Rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe iii. “Mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë.”*

III.2.3. Në nenin 113, pika, të ligjit nr.162/2020, dt. 23.12.2020 “Për prokurimin publik” është parashikuar: “1. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, afati kohor për paraqitjen e këtyre argumenteve është 7 ditë nga publikimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 5 ditë.

2. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumente që kundërshtojnë ankesën, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, nuk mund të ushtrojnë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë në lidhje me ankesën për këtë procedurë prokurimi.

III.2.4. Në kreun X “Zhvillimi i Procedurave ”, neni 101, të Vendimit nr.285 të Këshillit të Ministrave datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se “Për shqyrtimin e ankesave, autoriteti/enti kontraktor ndjek hapat e mëposhtëm:
1. Titullari i autoritetit/entit kontraktor, me urdhër të veçantë, cakton një person ose ngre një komision të përbërë nga të paktën 3 (tre) persona për shqyrtimin e ankesës. Të paktën njëri nga

anëtarët e komisionit për shqyrtimin e ankesës duhet të jetë ekspert i fushës për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit për të cilin është paraqitur ankesa. Në rast se ankimi lidhet me dokumentet e tenderit, titullari i autoritetit/entit kontraktor mund t'ia ngarkojë shqyrtimin e ankesës komisionit të vlerësimit të ofertave ose ekspertit të fushës, anëtar i komisionit të vlerësimit të ofertave.”

III.2.5. Gjithashtu në nenin 94 të Vendimit nr 285 të Këshillit të Ministrave dt. 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se:

1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. 2. Operatori ekonomik ankimues duhet të dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entit kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. 3. Ankimuesi përdor formularin standard të ankesës, që përmban të paktën: emrin, adresën, adresën elektronike të ankimuesit, referencën e procedurës konkrete, bazën ligjore, si dhe një përshkrim të shkëlqes së pretenduar. Ankimuesi është i detyruar të bëjë pagesën e tarifës pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entit kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Kur është e mundur, ankimit i bashkëlidhet një kopje e aktit, që kundërshtohet.

III.2.6. Në nenin 102 pika 1 të Vendimit Nr.285 të Këshillit të Ministrave dt. 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se: [...]*1. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, sipas parashikimeve në këto rregulla, autoriteti/enti kontraktor, mund të vendosë:*

- a) pranimin e plotë të ankesës;*
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;*
- c) refuzimin e ankesës.*

2. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

3. Vendimi i autoritetit/entit kontraktor u komunikohet të gjitha subjekteve të përfshira në proces.

III.2.7. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci

juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike, (*Neni 4 i K.pr. Administrative*).

Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në nenin 3 të tij janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Në interpretim interpretim sistematik (domethënien e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), Komisioni i Prokurimit gjykon se ligjvënësi ka ndarë qartësisht dy momentet procedurale atë të vlerësimit të ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe momentin e dytë të garancisë procedurale të mbrojtjes së interesave të ligjshme të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, atë të ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor (rishikimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave) nga vetë autoriteti kontraktor, por nga një trupë e re, e cila nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesave me komisionin e vlerësimit të ofertave, shqyrtimin e ankesave nga K.Sh. A (Komisioni i Shqyrtimit të Ofertave). Normativa e mësipërme, parashikuar nga neni 113 i ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “*Për Prokurimin Publik*” të ndryshuar, rregullon të drejtën e personave të interesuar në një procedurë prokurimi për të paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik në kuadrin e rishikimit administrativ të kësaj procedure, e thënë ndryshe, legjitimimin për të vënë në lëvizje dhe investimin e autoritetit kontraktor për rishikimin e vendimit të KVO-së.

Sa më sipër Komisioni gjykon se arsyet e reja të skualifikimit dhënë nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, në tejkallim të kompetencave të saj, nuk merren në shqyrtim nga KPP.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “T&J Construction” SHPK në procedurën e prokurimit “*E hapur e thjeshtuar*”, me nr. REF-76107-02-13-2026, me objekt: “*Blerje pemë dekorative*”, me fond limit 2,483,333.33 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 02.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Pasurisë Publike Lushnje.
2. Autoriteti kontraktor, lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “T &J Construction” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

